




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK
Dep.	01-4917/15
Dep.	02
Nr. Ifaq.	
Broj stranica	
Nr. pages	
Nr. Prot.	
Br. Prot.	
Prot No.	
Data	
Datum	
Date	24.12.2015
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.12.2015, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllt rasti me nr. AKK-03-02-3976/15, për zyrtarin e lartë z. Nehat Terpeza, Këshilltar Komunal në Komunën e Lipjanit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të mundshëm të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-3976/15,që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Nehat Terpeza, Këshilltar Komunal në Komunën e Lipjanit janë zhvilluar procedurat e parapara për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

Gjatë kontrollit për identifikimin e rasteve të mundshme të konfliktit të interesit është vërejtur se zyrtari i lartë z. Nehat Terpeza figuron si person i autorizuar në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 13.11.2015, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Nehat Terpeza ka ardhur në zyrat e AKK-së, ku nga zyrtarët kompetent të ngarkuar me rastin është njoftuar me faktet dhe provat gjë posedon AKK-ja.

Zyrtari i lartë z. Nehat Terpeza, Këshilltar Komunal në Komunën e Lipjanit, është pajtuar me gjendjen por është arsyetuar se nuk ka pas njohuri lidhur me situatën e konfliktit të interesit por brenda afatit ligjor do të bez ndryshimet dhe do të veproj sipas ligjit ne fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Me datën 22.12.2015 kemi pranuar dokumentet zyrtare nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Nehat Terpeza nuk figuron me si person i autorizuar ne biznesin "N.T.P ERXHANI" me numër biznesi 80301626 .

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Nehat Terpeza, Këshilltar Komunal në Komunën e Lipjanit, duke ber ndryshimet ne biznes dhe duke hequr dorë nga ushtrimi i pozitës se personit të autorizuar në biznesin privat dhe pasi janë krijuar rrëthana të reja konstatojmë se është shëmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari kontaktues )

